



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

Në bazë të nenit 3 dhe 4 të Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikantëve në Gjykata, për Praktikant Vullnetarë (pa pagesë), për kohë të caktuar prej një (1) viti,

**Gjykata Themelore në Prizren,
Shpall:**

K O N K U R S
Nr.01/2021

Titulli i vendit të punës: Praktikant Vullnetar (pa pagesë)

- 1.Gjykata Themelore në Prizren----- 30 pozita**
2.Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë----- 20 pozita
3.Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Dragash----- 10 pozita

Nëpunësi mbikëqyrës: Administrator i Gjykatës-Ndihmës Administratori-në degë.

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar në kohëzgjatje prej një (1) viti, pa pagesë.

Vendi: Gjykata Themelore në Prizren dhe degët në Suharekë dhe Dragash

Përshkrimi i detyrave të punës:

Detyrat e Praktikantit: Ndhmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

Detyrat kryesore:

- ❖ Ndhmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve, si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi.
- ❖ Ndhmon gjyqtarët në punët që kanë të bëjnë në futjen e lëndëve në dosje.
- ❖ Ndhmon në punën e zyrave të ndryshme në gjykatë, duke përfshirë regjistrimin, hetimet, gjykimet e të tjera.
- ❖ Kryen edhe pune tjera sipas nevojës.

Kualifikimet:

- Diplomë e Fakultetit Juridik, programi i studimeve (4) vjeçar apo 240 kredi ECTS ose Master.
- Njohuri të procedurave gjyqësore.
- Aftësi për kryerjen e procedurave gjyqësore (juridike).
- Njohuri të mjaftueshme ligjore.
- Aftësi të shkëlqyeshme për përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

VËREJTJE:

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatë të jashtëm dhe nëpunës civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Shërbimin Civil (Ligji Nr.03/L-149, dhe Rregullores për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores për procedurën e rekrutimit të Praktikantëve (Rregullorja Nr. 02/2010).
- Kohëzgjatja e emërimit: **Me kohë të caktuar.**

Konkursi është publikuar më datën 16.12.2021 dhe mbyllet më datën 30.12.2021.

Aplikacionet mund t'i merrni në Zyrën e Pranimit në Gjykatën Themelore në Prizren, Rr. "William Walker", P.nr., dhe po ashtu, aplikacionet mund t'i shkarkoni në mënyrë elektronike në Web portalin e Këshilli Gjyqësor të Kosovës: <https://www.gjyqesori-rks.org/>

[Shkarko Aplikacionin](#)

Aplikacionet e plotësuara mund t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Prizren, Rr. "William Walker", P.nr.,

- Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha personat e gjinisë mashkullore dhe femërore dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- Komuniteti jo shumicë kanë të drejtë përfaqësimi proporcional në organet e Shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës .

Aplikacioni e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçar. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe të lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të plotësohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën aplikohet.

Aplikacionit duhet të i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për aplikim, siç janë:

- -Kopja e diplomës për shkollën e kryer
- -Specializimet e ndryshme profesionale
- -Certifikata të tjera, vërtetime, rekomandime etj.
- -Certifikatë që nuk është nën hetime

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, aplikacionet nuk do të shqyrtohen.

Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion, kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin mbrapa.

Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësie mund të dërgoni pyetje në e-mailin:

gjthprizren@rks-gov.net